Raporti individual i konsultimit publik

1. Titulli i projekt aktit

Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr.581 datë 6.10.2021 të Keshillit te Ministrave "Për miratimin e kontributit kombëtar të përcaktuar".

Kontributi Kombëtar i Përcaktuar është dokumenti kryesor i zbatimit të Marrëveshjes së Parisit në nivel kombëtar, përmes të cilit Shqipëria përcakton objektivat, politikat dhe masat për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen ndaj tyre, në përputhje me rrethanat dhe kapacitetet e saj si vend në zhvillim (Non-Annex I) në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike. Në bazë të Marrëveshjes së Parisit, Shqipëria ka detyrimin të paraqesë dhe të përditësojë dokumentin çdo pesë vjet, duke rritur gradualisht nivelin e ambicies, si dhe të raportojë mbi zbatimin e saj përmes Raporteve Dyvjeçare të Transparencës (BTR).

Përmes këtij projektakti synohet arritja e objektivave kryesore, si më poshtë:

1. Miratimi i KKP 3. 0 si dokument kombëtar udhëzues për politikat klimatike të vendit, duke përcaktuar objektivat e zbutjes dhe përshtatjes për 2026-2035 dhe qasjen e zbatimit.
2. Forcimi i koordinimit ndërinstucional për planifikimin dhe zbatimin e masave klimatike, përmes harmonizimit të rolit të institucioneve përgjegjëse dhe angazhimit të ministrive të linjës.
3. Rritja e koherencës poltike ndërmjet KKP 3.0 dhe dokumenteve kryesore kombëtare (PKEP/PKP, strategji sektorale,) me qëllim që politikat klimatike të jenë të integruara dhe të zbatueshme;
4. Mbështetja e mekanizmave të transparencës, monitorimit dhe raportimit, në përputhje me Kornizën e Transparencës së Përmirësuar (ETF) nën Marrëveshjen e Parisit dhe proceset kombëtare të inventarit dhe raportimit (p.sh. raportet e transparencës dhe inventarit).
5. Orientimi i nevojave për financim dhe planifikimin afatmesëm të investimeve klimatike, duke u mbështetur në vlerësimet dhe kostot e referuara nga PKEK dhe PKP, si bazë për planifikim buxhetor dhe mobilizim burimesh.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse

kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Kohëzgjatja e konsultimit publik për këtë akt ishte 20 ditë pune nga data e shpalljes së njoftimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, bazuar në ligjin 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik.

Publikimi u bë në datë 18.3.2026 dhe nëpërmjet një njoftimi të publikuar online në RENJK, të gjitha palët e interesuara: 1) organet publike; 2) shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit; ishin të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për projektaktin, në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik në Ministrinë e Mjedisit.

Data e mbylljes së procesit të konsultimit publik ishte 15.4.2026.

Projektvendimi "Për një ndryshim në vendimin nr.581 datë 6.10.2021 të Keshillit të Ministrave "Për miratimin e kontributit kombëtar të përcaktuar, relacioni përkatës si dhe njoftimi për konsultim publik, u publikuan në linkun, www.konsultimipublik.gov.al.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese…, dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Projektvendimi, në zbatim të ligjit 146/2014, i është nënshtruar procesit të konsultimit publik, në portalin "Regjistri elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike", nga data 18.3.2026 deri në datën 15.4.2026.

Përgjatë kësaj periudhe ka patur 470 shikime në RENJKP, por nuk janë regjistruar komente në RENJKP dhe as nëpërmjet postës elektronike.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.
Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Hartimi i dokumentit është realizuar përmes një procesi konsultativ dhe ndërinstitucional, me përfshirjen e ministrive të linjës, përfshirë institucionet përgjegjëse për energjinë dhe infrastrukturën, bujqësinë, turizmin, shëndetësinë etj. Këto institucione kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në ofrimin e inputeve sektoriale dhe në sigurimin e koherencës së masave të zbutjes dhe përshtatjes me politikat dhe planet sektoriale përkatëse.

Procesi i hartimit të projektvendimit është mbështetur gjithashtu nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, të angazhuar përmes mbështetjes së GIZ dhe UNDP për sektorin e përshtatjes të cilët kanë kontribuar në hartimin teknik të dokumentit në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes së Parisit dhe të Kornizës së Përmirësuar të Transparencës.

5. Pasqyra e komenteve të pranuara me arsyetimin e komenteve të pranuara/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuara sipas çështjes që ato ngritën;
Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;
Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Nuk ka patur komente gjatë procesit të konsultimit publik.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi	Justifikimi